

L I G J
Nr.7525, datë 3.12.1991

**PËR ANËTARËSINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BANKËN EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pranohet marreveshja e themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 2

Pranohet anëtarësia e Republikës së Shqipërisë në këtë Bankë, sipas kushteve të parashikuara në rezolutën nr.15 të Këshillit të Drejtorëve të Bankës.

Neni 3

Autorizohet Kryetari i Këshillit të Ministrave të nënshkruajë në emër të shtetit shqiptar, kërkesën për pranimin në këtë Bankë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.81, datë 3.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia.